

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Katër nga 21 serbët që gjykohen në mungesë raportohen të vdekur
ADRESA	https://albeu.com/kosove/kater-nga-21-serbet-qe-gjykohen-ne-mungese-raportohen-te-vdekur/1030802/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 11:23:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 11:19:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	db19143e43ab7db776858d9b7c9dc77d702a35a53c80a0c0889f28b9cb5c401f
TEKSTI	a61225503ae87fdd0bad7cdc50c9e2f850d88e4dea91008befebddf2ba206ffb
PAMJA	cdace28f20a3c99017b43ba601b30676ebcb40c6972e8ad3733609f0ad31bfc5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	66be12ec7f3ae6d019999222a2aedd7100eed0813260b1267a6ea57032fc3a47
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b4355a68894c65a63b1e90d1f962746a91a9c18b00f6b0772c3894db0f3539f0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/66be12ec7f3ae6d019999222a2aedd7100eed0813260b1267a6ea57032fc3a47>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Katër nga 21 serbët që gjykohen në mungesë raportohen të vdekur



Katër nga 21 personat e akuzuar për dëbimin me forcë të mbi 800 mijë civilëve shqiptarë nga Kosova gjatë luftës së viteve 1998-'99 raportohet se kanë vdekur. Megjithatë, deri tani nuk është paraqitur asnjë dokument zyrtar që e vërteton këtë për gjykimin që po zhvillohet në mungesë.

Në seancën fillestare, prokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës, Atdhe Dema, bëri të ditur se katër të akuzuar figurojnë të vdekur, por nuk ua përmendi emrat. Ai njoftoi gjithashtu se hetimi ndaj të dyshuarve për krime lufte kishte zgjatur tre vjet para se çështja të dërgohej në gjykatë.

Dema: Katër të akuzuar figurojnë të vdekur

"Pas tre vitesh hetime, Prokuroria Speciale ka dorëzuar në gjykatë përmbajtjen për shqyrtimin gjyqësor në mungesë. Për katër prej tyre figuron se kanë ndërruar jetë, por deri më sot nuk kemi marrë dokument zyrtar nga institucionet kompetente", deklaroi Dema.

Nga 21 avokatët e caktuar kryesisht për mbrojtjen e të akuzuarve, 20 mbështetën vazhdimin e seancës në mungesë. Përjashtim bëri avokati Shkumbin Asllani, i cili kërkoi që klienti i tij të njoftohej për shqyrtimin gjyqësor.

Asllani: Të mbrojturit tim duhet t'i bëhet njoftimi për shqyrtimin gjyqësor

"Pavarësisht veprimeve të prokurorisë lidhur me sigurimin e të pandehurve, duhet të verifikoj nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e nenit 303, konkretisht nëse janë përmbushur detyrimet për njoftimin efektiv të të mbrojturit tim për shqyrtimin gjyqësor", tha Asllani.

Kryetarja e trupit gjykues, Medie Bytyqi, deklaroi se gjykata kishte shteruar përpjekjet ligjore për të siguruar praninë e të akuzuarve. Meqë kjo nuk ishte arritur, gjykata kishte vlerësuar se procesi mund të vazhdonte në mungesë.

të fundit /



PDK-ja kërkon miratimin me urgjencë të ndryshimeve në...



Vlora Çitaku merr postin e nënkryetares së Kuvendit me votat ...



Katër nga 21 serbët që gjykohen në mungesë raportohen të vdekur



Shqipëria përfundon stërvitjen në "Shtëpinë e Futbollit" para sfidë...



Agit Kabayel i përgjigjet sfidës së Nelson Hysës: Pranon duelin...



Betohen 15 deputetët e rinj që zëvendësojnë ministrat në Kuvend



Andersson heq dorë nga përpjekja për qeverinë suedeze pa...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Bytyqi shtoi se, sipas vlerësimit të gjykatës, ishin bërë përpjekje të mjaftueshme për gjetjen dhe sigurimin e të pandehurve.

Bytyqi: Nuk kemi të dhëna për vendndodhjen e të akuzuarve

"Gjykata u ka bërë thirrje të akuzuarve të dorëzohen, por deri tani nuk kemi marrë nga policia asnjë informacion për vendndodhjen e tyre. Gjykata ka marrë parasysh edhe faktin se bëhet fjalë për vepër penale të krimeve të luftës", u shpreh ajo.

Seanca nisi një orë më vonë se orari i planifikuar. Për vonesën, avokatja Albana Zogiani u gjobit me një mijë euro.

Bytyqi: Avokatja që u vonua gjobitet me 1 mijë euro

"Në përputhje me dispozitat e Kodit Penal, gjykata vendos t'i shqiptojë avokates Albana Zogiani gjobë prej 1000 eurosh për vonesën në seancë, ndonëse ishte njoftuar se ajo do të vazhdonte në orën 9:30. Ajo mbërriti në orën 10:30", tha gjyqtarja.

Prokuroria Speciale akuzon 21 personat se, nga janari deri në qershor të vitit 1999, gjatë konfliktit të armatosur dhe luftës në Kosovë, ushtruan autoritet dhe kontroll efektiv mbi forcat që vepronin nën përgjegjësinë e tyre.

Sipas aktakuzës, ata kishin në dispozicion raporte operative dhe komunikime të brendshme, si dhe ndodheshin në zona ku mund të merrnin dijeni për veprimet e forcave nën komandën apo kontrollin e tyre. Këto veprime përfshinin shkatërrimin e pronës, djegien e shtëpive dhe objekteve të infrastrukturës civile, përndjekjen dhe ndalimin arbitrar të personave për arsye etnike, si dhe sulme të armatosura ndaj fshatrave e qyteteve me popullsi civile shqiptare, me synimin për t'i zhvendosur me forcë.

Aktakuza thotë se veprimet përfunduan me organizimin e kolonave të civilëve shqiptarë, të cilët u dëbuan nga Kosova drejt kufijve të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Numri i përgjithshëm i të dëbuarve, sipas dokumentit, ishte rreth 862,979.

Prokuroria pretendon se të pandehurit nuk morën masat e nevojshme dhe të arsyeshme që ishin në kompetencën dhe përgjegjësinë e tyre për të parandaluar këto veprime, për t'i ndaluar autorët apo për t'ua raportuar shkeljet autoriteteve përkatëse. Ata akuzohen për krime lufte kundër popullatës civile.

Të akuzuarit janë Zlatimir Peshiq, Mladen Cirković, Radomir Marković, Dushko Adamović, Obrad Stevanović, Zhivko Trajković, Goran Radosavljević, Bogoljub Janičević, Sllavisha Ivanović, Boshko Vukićević, Sreten Popović, Nikolla Petrović, Krsman Jelić, Ljubisha Stojimirović, Bozhidar Delić, Radojko Stefanović, Dragan Zhivanović, Millosh Doshan, Ljubinko Cvetić, Bozhidar Filić dhe Millovan Kovačević.

Shtuar më 28.09.2026 13:19

Tags: [akuza](#), [serbe](#), [vdekur](#)



PDK-ja kërkon miratimin me urgjencë të ndryshimeve në Ligjin për...



Vlora Çitaku merr postin e nënkryetares së Kuvendit me votat e PDK-së



Betohen 15 deputetët e rinj që zëvendësojnë ministrat në Kuvend



Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës nuk nis ende, kalon mesdita



Hamza pas takimit me Kurtin: Miratimi i ligjit për Dhomat e Specializuara...



Ish-ushtaraku për reagimin e Vuçevićit ndaj arrestimeve: Serbia po e...



Lushtaku: Takimi Kurti-Hamza dhe qëndrimi i PDK-së për Dhomat e...



IPAK kërkon shqyrtim të pavarur të gjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.